



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKÀ KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	273
Nr. i fq. / Br. st	- 5 -
Data: / Datum	28. 09. 2017
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

RREGULLORE (KKV) NR.02/2017
PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME
PËR VITIN 2018

Shtator, 2017

Bazuar në nenin 12.1, 12.2 pika "c" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, në Ligjin nr.03/L-204 mbi tatimin në pronën e paluajtshme dhe nenin 7 të Ligjit nr.04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, nenin 41.2 pika "c" e Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur, më **28 shtator 2017**, miraton këtë:

RREGULLORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2018

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet tatimi mbi pronën e paluajtshme, kriteret për caktimin e bazës tatimore, shkalla (norma) tatimore, vlerësimi i pronës, shuma e detyrimit dhe ndarja e zonave të vlerësimit për pasurinë e paluajtshme në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Komuna e Vushtrrisë mbledhjen e tatimit në pronat e paluajtshme brenda kufijve të saj e realizon në përputhje me Ligjin nr.03/L-204 mbi Tatimin në Pronat e Paluajtshme.

Objekti i vënies së tatimit në pronë

Neni 3

Tatimi mbi pronën do të vihet mbi tërë pronën e paluajtshme në komunë, me përjashtim të pronës, e cila lirohet nga tatimi në pajtim me nenin 8 të Ligjit nr.03/L-204.

Tatimpaguesi

Neni 4

- 4.1. Personi përgjegjës për pagesën e tatimit mbi pronën (më tej tatimpaguesi) është para së gjithash pronari i pronës;
- 4.2. Nëse pronari i pronës nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të gjendet, tatimpaguesi është personi fizik ose juridik i cili e shfrytëzon ose e mban pronën e paluajtshme;
- 4.3. Nëse pronari ose shfrytëzuesi i ligjshëm i pronës së paluajtshme nuk mund të përcaktohet ose mund të përcaktohet, por nuk ka qasje ndaj pronës së paluajtshme, tatimpaguesi do të jetë personi fizik ose juridik i cili e shfrytëzon pronën dhe në këtë rast shfrytëzuesit nuk i njihet e drejta e pronësisë.

Baza e tatimit

Neni 5

- 5.1. Bazë e tatimit për tatimin mbi pronën do të jetë vlera e pronës në treg e përcaktuar në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr.03/L-204 të tatimit në pronë;
- 5.2. Për çdo vit tatimor vlerë e tregut e cilësdo pronë është vlera e pronës më 31 dhjetor të vitit paraprak.

Neni 6

Në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr.04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, norma e tatimit në pronë për pronat e paluajtshme për vitin 2018 në Komunën e Vushtrrisë është si vijon:

Lloji i pronës	Norma e tatimit në %
Pronë rezidenciale (banesë-apartament)	0.15
Pronë rezidenciale - shtëpi	0.15
Pronë komerciale	0.21
Pronë industriale	0.18
Pronë bujqësore	0.15
Pronat e pamermetuara dhe jo të gatshme për banim	0.15
Garazhet	0.15
Pronat e braktisura	0.15
Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive etj).	0.21
Pronat e pamermetuara dhe jo të gatshme komerciale	0.20

Vlerësimi i pronës

Neni 7

Kriter për vlerësimin e pronës dhe caktimin e bazës tatimore në këtë rregullore do të merret neni 13 i Ligjit nr.03/L-204 dhe Udhëzimi Administrativ nr. 4/2011, i lëshuar nga MF-së.

Neni 8

Caktimi i bazës tatimore nëpër zona caktohet si më poshtë:

Bazuar në vendndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e tregut në Komunën e Vushtrrisë janë përcaktuar gjashtë (VI) zona, të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Vlera e tregut në € për m² sipas zonave:

Destinimi i pronës	Zona e I	Zona e II	Zona e III	Zona e IV	Zona e V	Zona e VI
Pronë rezidenciale-banesë	400€	350€	320€	300€	290€	250€
Pronë rezidenciale-shtëpi	330€	290€	250€	230€	210€	180€
Pronë komerciale	800€	700€	550€	500€	400€	300€
Pronë industriale	180€	150€	110€	100€	80€	60€
Pronë bujqësore	150€	150€	100€	80€	60€	50€
Pronat e pamermetuara	160€	140€	120€	110€	100€	80€

dhe jo të gatshme për banim						
Garazhet	200€	200€	100€	90€	80€	60€
Pronat e braktisura	200€	200€	150€	120€	100€	100€
Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive)	150€	150€	150€	150€	150€	150€
Pronat e pamermetuara - jo të gatshme komerciale	480€	400€	320€	300€	240€	160€

Zona e parë – Fillon nga Kosova Petrolli dhe përfshinë të gjitha objektet në të dy anët e rrugëve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këto rrugë: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe “Dëshmorët e Kombit” deri te Ura e Hekurit, rrugën “Bedri Pejani”, rrugën “Nexhip dhe Ferat Draga” në të dy anët e rrugës (prej rrethit deri te ura mbi lumin “Tërstena”), vazhdon përgjatë lumit “Tërstena” (ana e majtë deri te Ura e Hekurit), rrugën “Çamëria”, rrugën “Ismajl Qemajli” bri rrugës deri në magjistrale, rrugën e “Krujës” deri te rruga “Dëshmorët e Kombit” dhe përfshin të gjitha rrugët - objektet të cilat gjenden brenda kësaj zone.

Zona e dytë - fillon nga lumi “Banjska” përgjatë magjistrales Mitrovicë – Prishtinë deri te udhëkryqi i rrugës Nadakoc (ana e djathtë dhe ana e majtë, objektet bri rrugës). Prej kryqëzimit të magjistrales me lumin “Sllatina” përgjatë këtij lumi e deri te ura mbi lumin “Silnica”, vazhdon përgjatë lumit “Silnica”, ku bashkohet me lumin “Tërstena”. Nga kjo pikë vazhdon përgjatë lumit “Tërstena” deri te ambulanta e vjetër, pastaj rrugës “Enver Musa” (në të dy anët e rrugës) deri te udhëkryqi te varrezat dhe vazhdon tutje në rrugën “Faruk Beqiri” (në të dy anët e rrugës duke përfshirë vetëm objektet e para), mandej në rr. “Dëshmorët e Kombit” (në të dy anët e rrugës) deri te kyçja në magjistrale dhe përfshin të gjitha rrugët-objektet, të cilat gjenden brenda kësaj zone.

Zona e tretë - përfshin pjesën periferike të qytetit jashtë zonës së dytë, por brenda kufijve të Zonës Kadastrale Vushtrri, si dhe të gjitha objektet komerciale përgjatë magjistrales nga fshati Gracë gjer në kufirin e zonës së dytë (II) dhe nga lumi “Banjskë” deri në Smrekonicë.

Zona e katërt – përfshin këto fshatra: Akrahticë, Begaj, Bukosh, Dalak, Dobërllukë, Druar, Dumnicë e Poshtme, Gojbulë, Gracë, Lumadh, Mavriq, Maxhunaj, Mihaliq, Miraçë, Nedakoc, Novolan, Pantinë, Pestovë, Prelluzhë, Reznik, Ropicë, Samadrexhë, Sfaraçak i Epërm, Sfaraçak i Poshtëm, Shtitaricë, Sllatinë, Smrekonicë, Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm, Studime e Poshtme, Vërnice, Vilanc.

Zona e pestë - përfshin këto fshatra; Balincë, Beçiq, Beçuk, Bivolak, Brusnik, Ceceli, Duboc, Dumnicë e Llugës, Galicë, Gllavatin, Hercegovë, Karaçë, Kollë, Jezerë, Oshlan, Pasomë, Shalë, Sllakoc, Stroc, Studime e Epërme, Taraxhë, Zhilivodë.

Zona e gjashtë - përfshin këto fshatra: Boshlan, Dumnicë e Epërme, Gumnishtë, Kunovik, Kurillovë, Shilovicë, Skoçan, Skromë, Tërllobuq, Vesekoc, Zagorë.

Pagesa e tatimit në pronë

Neni 9

Për vitin tatimor, tatimi i caktuar sipas kësaj rregulloreje duhet të paguhet në dy këste të barabarta: kësti i parë deri më 30 qershor dhe kësti i dytë më së largu deri më 31 dhjetor të vitit tatimor.

Ankesat administrative

Neni 10

Në pajtim me nenin 4 të Ligjit 04/L-100 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe të Udhëzimit Administrativ Nr. 5/2003 të MEF-it, Kryetari i komunës e emëron Bordin komunal për shqyrtimin e ankesave në tatimin e pronës së paluajtshme.

Neni 11

Dispozitat të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore dhe që kanë të bëjnë me tatimin në pronë, do të aplikohen dispozitat e Ligjit 03/L-204 mbi tatimin në pronën e paluajtshme.


Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.1.2018, si dhe e njëjta do të zbatohet gjatë vitit 2018.

Neni 13

Nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja komunale nr.175/16, datë: 29.09.2016 për vitin 2017 mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Kryesues i Kuvendit


Shpëtim Zhegrova